

Kushtet e shërbimit të përdoruesit fundor të ndërmarrjes

Data e versionit: 1 prill 2023

Me kushtet e shërbimit të përdoruesit fundor ("Kushtet e shërbimit", "KeSH" ose "Kushtet") nënkuptohet kontrata ligjore mes jush dhe "Lookout" ("Lookout", "ne", "tonë").

Mund të jeni udhëzuar të shkarkoni dhe instaloni Shërbimin e Sigurisë së Ndërmarrjes "Lookout" ("Shërbimet" ose "Shërbimet e Ndërmarrjes") si rrjedhojë e punësimit tuaj në një organizatë që (1) kërkon që e gjithë fuqia punëtore ose një pjesë e saj të instalojë Shërbimet e Ndërmarrjes ose (2) kërkon që e gjithë fuqia punëtore ose një pjesë e saj të instalojë një panel për menaxhimin e pajisjes, ku përfshihen Shërbimet e Ndërmarrjes. Këto kushte rregullojnë aksesimin dhe përdorimin tuaj të Shërbimeve të Ndërmarrjes. Duke përdorur Shërbimet e Ndërmarrjes, dhe përveç rasteve kur Ndërmarrja juaj ka një marrëveshje kuadër license me "Lookout", që i përfshin këto Kushte, ju bini dakord që t'u nënshtroheni këtyre Kushteve të Shërbimit.

Mund t'i përdorni Shërbimet e Ndërmarrjes vetëm nëse lidhni një kontratë detyruese me "Lookout" dhe nuk jeni person që ju ndalohet të përdorni shërbimin sipas ligjeve të Shteteve të Bashkuara ose juridiksionit të zbatueshëm. Mund t'i përdorni Shërbimet e Ndërmarrjes vetëm në përputhje me këto Kushte dhe me ligjet, rregullat dhe rregulloret vendore, shtetërore, kombëtare dhe ndërkombëtare në zbatim. Nuk mund t'i përdorni Shërbimet tona nëse jeni nën moshën 16 vjeç.

1. Të drejtat e "Lookout"

- a. Licensojmë Shërbimet tona për ju: "Lookout" ju jep një licensë personale, joekskluzive, të patransferueshme, të panënlicensueshme, të revokueshme, për t'i përdorur Shërbimet e Ndërmarrjes sipas kushteve përkatëse.
- b. "Lookout" rezervon të gjitha të drejtat për Shërbimet e Ndërmarrjes: Të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat ndaj dhe për Shërbimet e Ndërmarrjes janë dhe do të mbeten pronë vetëm e "Lookout". Shërbimet e Ndërmarrjes mbrohen nga ligjet për pronësinë intelektuale dhe të drejtat e tjera pronësore në Shtetet e Bashkuara dhe vendet e huaja. "Lookout" nuk ju jep licensa për Shërbimet e Ndërmarrjes ose përmbajtje të tjera të "Lookout" përveç atyre që jepen shprehimisht në KeSH, as të drejta për të përdorur apo përvetësuar, në asnjë mënyrë, markat tregtare, logot, emrat e domeneve, ose pronësitë intelektuale apo veçoritë e tjera të markës së "Lookout".
- c. Mund të modifikojmë Shërbimet e Ndërmarrjes: Ne rezervojmë të drejtën për të modifikuar, pezulluar ose anuluar Shërbimet e Ndërmarrjes (ose veçori të Shërbimeve të Ndërmarrjes) për ju, në çdo kohë dhe për çdo arsye. Në raste të tilla, do t'ju njoftojmë përmes aplikacionit në celular, me anë të emailit që na keni dhënë ose do t'ju njoftojë organizata juaj.
- d. Kodet e burimit të hapur dhe të palëve të treta zotërojnë licensat e tyre: Të gjitha kodet e burimit të hapur dhe të palëve të treta të përfshira në Shërbimet e Ndërmarrjes mbulohen nga marrëveshja e licensës e përdoruesit fundor të burimit të hapur ose të palëve të treta, nëse ka, që autorizon përdorimin e këtij kodi.
- e. Vlerësimi juaj: Nëse na jepni komente, ide ose vlerësime, pranoni që t'i përdorim ato pa kufizime ose kompensim ndaj jush.

2. Kufizime për përdorimin tuaj të Shërbimeve të Ndërmarrjes.

- a. Integriteti i informacioneve të llogarisë suaj është përgjegjësia juaj: Duhet të siguroheni që të gjitha infomacionet për llogarinë tuaj (p.sh., fjalëkalimi ose të dhënat e identifikimit) të jenë të sigurta, të sakta dhe të përditësuara në çdo kohë. Keni përgjegjësi të vetme dhe të plotë për të gjitha veprimet në llogarinë tuaj dhe ne nuk jemi përgjegjës për dëme ose detyrime që rrjedhin si pasojë e pamundësisë suaj që llogaria juaj të ketë informacione të sakta, të përditësuara e të sigurta. Ju bini dakord të na kontaktoni menjëherë në rast se dyshoni se një palë e paautorizuar mund të jetë duke përdorur llogarinë tuaj ose nëse dyshoni për shkelje të tjera të privatësisë.
- b. Respektoni ligjin dhe rregullat tona: Nuk mund t'i përdorni Shërbimet e Ndërmarrjes në asnjë mënyrë që shkel ligjet, rregulloret ose këto Kushte, dëmton një person, ose shkel të drejtat e një personi ose subjekti (përfshirë pronësinë intelektuale dhe të drejtat e tjera pronësore). Gjithashtu, pa kufizime, teksa përdorni Shërbimet e Ndërmarrjes nuk mund të:

1. Hakoni ose të ndërhyjni në Shërbimet e Ndërmarrjes, serverat e saj ose çdo rrjet të lidhur.
2. Përshtatni, ndryshoni, nënlicensoni ose përktheni Shërbimet e Ndërmarrjes për përdorim vetjak ose tregtar.
3. Hiqni ose ndryshoni, vizualisht ose në mënyra të tjera, të drejtat e autorit, markat tregtare ose markat pronësore dhe të drejtat në pronësi të "Lookout".
4. Regjistroheni me identitete ose emra të tjerë përdoruesish, pasi llogaria juaj të jetë pezulluar ose mbyllur.

c. Nuk mund ta anashkaloni sigurinë tonë: Mund të aksesoni dhe të përdorni Shërbimet e Ndërmarrjes vetëm përmes mjeteve që ju ofrojmë shprehimisht. Nuk mund t'i anashkaloni ose çaktivizoni Shërbimet e Ndërmarrjes ose teknologjitë, veçoritë apo masat e përfshira në Shërbimet e Ndërmarrjes për asnjë arsye, përveçse kur lejohet me ligj.

d. Respektoni pronësinë tonë intelektuale: Licenca e dhënë sipas këtyre Kushteve, ju jepet vetëm për qëllimin e përdorimit të Shërbimeve të Ndërmarrjes. Nuk mund të shkelni asnjë të drejtë ekskluzive që ne zotërojmë sipas ligjeve për të drejtat pronësore dhe pronësisë intelektuale. Nuk mund të gjeneroni, zbërtheni, analizoni pjesë-pjesë, apo të përpiqeni të merrni kodin burimor për pjesët e Shërbimeve të Ndërmarrjes, përfshirë përmbajtjet e ekzekutueshme ose të konfigurueshme, përveçse kur lejohet me ligj.

e. Mund ta përdorni "Lookout" vetëm për të siguruar pajisjen tuaj: Shërbimet tuaja ofrohen vetëm funksionimin dhe mbrojtjen e pajisjes(ve) suaj. Nuk mund ta ekzekutoni softuerin e "Lookout" në ndonjë mjedis tjetër, për shembull në një mjedis të ngjashëm, si instrument kërkimi ose në ndonjë mënyrë tjetër për të zhvilluar ose mbështetur një produkt tjetër, ose të përdorni rezultatet e marra nga përdorimi i klientit të "Lookout" për ndonjë qëllim tjetër, si për shembull për të verifikuar një grup rezultatesh të njohura ose për të analizuar, aktivizuar apo mbështetur shërbime të tjera, pa miratimin tonë të qartë me shkrim. Na kontaktoni në malware@lookout.com për të kërkuar akses.

f. Vetëm ju mund ta përdorni llogarinë tuaj: Nuk mund të shisni, të transferoni ose t'u jepni personave të tjerë akses në fjalëkalimin e llogarisë suaj ose llogarinë tuaj të Shërbimeve të Ndërmarrjes. Nuk mund të jepni informacione të pavërteta, çorientuese ose të pasakta, apo të lini të kuptohet se keni lidhje me kompani apo organizata me të cilat nuk jeni të lidhur.

3. Përdorimi i Shërbimeve të Ndërmarrjes.

Nëse krijoni një llogari për Shërbimet e Ndërmarrjes, duhet ta përdorni atë në përputhje me kushtet dhe politikat e punëdhënësit tuaj. Ju lutemi të keni parasysh se llogaritë për Shërbimet e Ndërmarrjes i nënshtrohen kontrollit të punëdhënësit dhe, administratori i llogarisë suaj për Shërbimet e Ndërmarrjes ka të drejtë të shohë statusin e sigurisë së pajisjes suaj. Ju mund të shkëputeni nga llogaria për Shërbimet e Ndërmarrjes duke kontaktuar administratorin tuaj të TI-së. Duke përdorur Shërbimet e Ndërmarrjes ju pohoni se keni kuptuar dhe keni pranuar që administratorët e Shërbimeve të Ndërmarrjes të kenë akses në informacione për aplikacione dashakeq ose informacione të tjera në pajisjen tuaj. Duke përdorur Shërbimet e Ndërmarrjes, bini dakord që "Lookout" të mos jetë përgjegjës në asnjë mënyrë për aksesimin dhe përdorimin e mundshëm të informacioneve të marra nga punëdhënësi juaj përmes Shërbimeve të Ndërmarrjes.

4. Privatësia juaj ka rëndësi për ne.

Është me rëndësi që të rishikoni [Deklaratën e Privatësisë](#), që rregullon mbledhjen, përdorimin dhe zbulimin e informacioneve tuaja personale. Ju lutemi ta lexoni me kujdes.

5. Mbyllja ose pezullimi i llogarisë suaj.

Mund të mbyllim ose pezullojmë aksesin tuaj te Shërbimet e Ndërmarrjes pa njoftim paraprak dhe pa detyrime, sipas përcaktimeve tona, përfshirë, por pa u kufizuar në mbyllje ose pezullim që bazohet në (a) besimin se i keni shkelur Kushtet ose (b) nëse përdorni Shërbimet në një mënyrë që na bën ligjërisht përgjegjës ose pengon përdoruesit e tjerë të Shërbimeve. Ne do të përpiqemi t'ju njoftojmë lidhur me mbylljen ose pezullimin e aksesit tuaj në Shërbimet e Ndërmarrjes përmes adresës së emailit të lidhur me llogarinë tuaj ose përmes aplikacionit "Lookout" në celular. Këto janë zgjidhje të tjera krahas atyre që "Lookout" mund të ketë sipas ligjit ose në kapital. Këto kushte do të vijojnë të jenë të zbatueshme kundër jush edhe pasi e drejta juaj për të përdorur Shërbimet e Ndërmarrjes të ketë përfunduar ose të jetë pezulluar.

6. Deklaratat për mospranim përgjegjësie, dëmshpërblimet dhe kufizimi i përgjegjësisë.

a. Deklaratat për mospranim përgjegjësie:

1. SHËRBIMET E NDËRMARRJES DHE ÇDO SOFTUER, SHËRBIM OSE APLIKACION I OFRUAR PËR SHËRBIMET E NDËRMARRJES, DO TË OFROHET "SIÇ ËSHTË", PA ASNJË LLOJ GARANCIE. NË MASËN MAKSIMALE QË LEJOHET NGA LIGJI NË ZBATIM, "LOOKOUT" DHE NJËSITË E TIJ EKONOMIKE, BASHKËPUNËTORËT, KOMPANITË E LIDHURA ME TË, NËPUNËSIT, DREJTUESIT, PUNËMARRËSIT, AGJENTËT, PARTNERËT, FURNITORËT, SHPËRNDARËSIT DHE LICENSUESIT E TIJ ("SUBJEKTET E LOOKOUT") REFUZOJNË TË GJITHA GARANCITË, TË SHPREHURA OSE TË NËNKUPTUARA, PËRFSHIRË (POR PA U KUFIZUAR NË) GARANCITË E NËNKUPTUARA TË TREGTUESHMËRISË, PËRSHTATMËRINË PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR, DHE MOSSHKELJEN E TË DREJTAVE PRONËSORE, OSE DISPONUESHMËRINË, BESUESHMËRINË APO SAKTËSINË E SHËRBIMEVE. JU JENI PËRGJEGJËS PËR ÇDO DËM NË PAJISJEN OSE APARATIN TUAJ, HUMBJE TË TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT OSE HUMBJE TË TË DHËNAVE.
2. PA U KUFIZUAR NË SA MË SIPËR, "LOOKOUT" DHE BASHKËPUNËTORËT E TIJ OSE LICENSUESIT NUK GARANTOJNË QË SHËRBIMI DO TË JETË I PANDËRPRERË OSE PA GABIME, DHE NUK JAPIN GARANCI PËR REZULTATET QË MUND TË MERREN NGA PËRDORIMI I SHËRBIMEVE OSE PËR SHPEJTËSINË, SAKTËSINË, PLOTËSINË, APO PËRMBAJTJEN E SHËRBIMEVE, INFORMACIONEVE OSE MATERIALEVE TË OFRUARA PËRMES OSE NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E SHËRBIMIT.
3. "LOOKOUT" DHE BASHKËPUNËTORËT E TIJ OSE LICENSUESIT NUK JANË PËRGJEGJËS PËR SJELLJEN E PËRDORUESVE ONLINE OSE OFFLINE.
4. "LOOKOUT" DHE BASHKËPUNËTORËT E TIJ DHE LICENSUESIT NUK GARANTOJNË SE INFORMACIONET PERSONALE TË DHËNA NGA JU NUK DO TË KEQPËRDOREN, PËRGJOHEN, FSHIHEN, SHKATËRROHEN OSE PËRDOREN NGA TË TJERËT.

b. Dëmshpërblimet: Ju bini dakord të dëmshpërbleni "Lookout" dhe Bashkëpunëtorët e "Lookout" dhe ta mbronin nga pretendimet, paditë, veprimet, humbjet, kostot, dëmet dhe përgjegjësitë e tjera, përfshirë tarifat e avokatëve, që lindin ose që lidhen me (a) keqpërdorimin nga ana tuaj të Shërbimeve të Ndërmarrjes, (b) shkeljet e të drejtave të një personi ose subjekti nga përdorimi ose keqpërdorimi nga ana tuaj i Shërbimeve të Ndërmarrjes, ose (c) cenimin e ndonjë pjese të KeSH-it nga ana tuaj. "Lookout" rezervon të drejtën, që me shpenzimet tuaja, të kërkojë mbrojtje ekskluzive dhe inspektim të çdo çështjeje për të cilën kërkohet dëmshpërblim nga ju, dhe ju bini dakord të bashkëpunoni me palën mbrojtëse të pretendimeve tona. Në asnjë mënyrë, nuk do të zgjidhni një pretendim apo çështje që lidhet me "Lookout" pa miratimin me shkrim të "Lookout".

c. Kufizimi i përgjegjësisë: NË MASËN MAKSIMALE QË LEJOHET NGA LIGJI NË ZBATIM, "LOOKOUT" DHE BASHKËPUNËTORËT E TIJ DO TË JENË PËRGJEGJËS PËR ÇDO DËM TË VEÇANTË, TË TËRTHORTË, AKSIDENTAL, NDËSHKIMOR, TË KOMPENSUESHËM, RRJEDHIMOR OSE TË JASHTËZAKONSHËM NDAJ JUSH LIDHUR ME PËRDORIMIN TUAJ TË SHËRBIMEVE TË NDËRMARRJES, EDHE NËSE "LOOKOUT" ËSHTË KËSHILLUAR PËR MUNDËSINË E KËTYRE DËMEVE DHE NËSE NJË ZGJIDHJE NUK MUND TË PËRMBUSHË QËLLIMIN E VET THELBËSOR. PËRGJEGJËSIA E PËRGJITHSHME E "LOOKOUT" DHE BASHKËPUNËTORËVE TË TIJ PËR ÇDO DËM, HUMBJE OSE PASOJA VEPRIMESH QË RRJEDHIN OSE LIDHEN ME KËTË KeSH NË ASNJË RAST NUK MUND TË TEJKALOHË (1) SHUMËN E PAGUAR NGA PUNËDHËNËSI JUAJ PËR SHËRBIMET E NDËRMARRJES TË PËRDORURA NGA JU GJATË DYMBËDHJETË (12) MUAJVE NË VIJIMI TË DATËS SË PRETENDIMIT TUAJ OSE (2) NJË MIJË DOLLARË AMERIKANË, CILADO SHUMË QOFTË MË E MADHJA.

7. Juridiksioni dhe legjislacioni i zbatueshëm

a. Ju lutemi të kontaktoni me ne fillimisht: Qëllimi ynë është të jeni të lumtur dhe të kënaqur me përdorimin tuaj të Shërbimeve të Ndërmarrjes. Nëse keni një mosmarrëveshje me "Lookout", ju bini dakord të na kontaktoni në enterprisesupport@lookout.com dhe të përpiqeni, me mirëbesim, ta zgjidhni mosmarrëveshjen me ne. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 60 ditëve nga njoftimi, ju ose "Lookout" mund të hapni një proces gjyqësor formal.

b. Ju bini dakord për arbitrazh: Në masën e lejuar nga ligji i juridiksionit tuaj, çdo mosmarrëveshje, pretendim ose kundërshtim që rrjedh nga ose lidhet me Shërbimet e Ndërmarrjes, kjo Marrëveshje ose cenimi, zgjidhja, zbatimi, interpretimi ose vlefshmëria e saj, përfshirë përcaktimin e qëllimit ose zbatueshmërisë së marrëveshjes

për arbitrazh, i paraqitet një arbitri për arbitrazh përfundimtra dhe detyruet në shtetin e Nju Jorkut, ose një vendndodhje tjetër për të cilën palët bien dakord me shkrim. Arbitrazhi administrohet nga Arbitrazhi Gjyqësor dhe Shërbimet e Ndërmjetësimit ("AGJSHN") në përputhje me Procedurat dhe Rregullat e Arbitrazhit Gjithëpërfshirës dhe sipas procedurave të përshpejtuara në këto rregulla (së bashku "Rregullat e AGJSHN-së"), të dyja të disponueshme në faqen e internetit të AGJSHN-së www.jamsadr.com. Gjykimi përfundimtar mund të jepet nga çdo gjykatë që është pjesë e juridiksionit. Kjo klauzolë nuk i pengon palët të kërkojnë zgjidhje paraprake për ndihmë gjatë arbitrazhit nga gjykatat e një juridiksioni të përshtatshëm. Palët do të bashkëpunojnë me AGJSHN-në dhe njëra-tjetrën për përzgjedhjen e një arbitri nga paneli i personave të paanshëm të AGJSHN-së dhe për planifikimin e procesit gjyqësor. Tarifat e arbitrazhit dhe përqindja e kompensimit të arbitrit tuaj do të rregullohen nga rregullat e AGJSHN-së. Arbitri mund t'i caktojë palës fituese, nëse ka, kostot dhe tarifën e avokatëve të shkaktuara në mënyrë të arsyeshme nga pala fituese për çdo arbitrazh që rrjedh nga ose ka të bëjë me përdorimin e Shërbimeve të Ndërmarrjes ose të këtij Marrëveshjeje. Nëse arbitri e përcakton se pala fituese fiton për disa, por jo për të gjitha pretendimet dhe kundërp pretendimet, ai mund t'i caktojë palës fituese një përqindje të përshtatshme të kostove dhe tarifave të avokatëve të shkaktuara në mënyrë të arsyeshme nga pala fituese për arbitrazhin.

c. Përrjashtim nga arbitrazhi: Secila nga palët mund të ngrejë një padi në gjykatat shtetërore ose federale në Nju Jork për masa të ngutshme për ndalimin e përdorimit të paautorizuar ose abuzimit me Shërbimet, ose shkeljen e të drejtave të pronësis intelektuale, pa u përfshirë menjëherë në procesin joformal të njoftimit për mosmarrëveshje, siç përshkruhet më sipër.

d. Vetëm për të licensuarit në SHBA - Heqje dorë për të qenë palë paditëse ose anëtarë klasi në një veprim të pretenduar klasi ose procedurë me përfaqësim: Ju dhe "Lookout" bini dakord se çdo arbitrazh do të kufizohet në mosmarrëveshjen mes jush dhe "Lookout". JU PRANONI DHE BINI DAKORD SE JU DHE "LOOKOUT" HIQNI DORË NGA TË QENIT PALA PADITËSE OSE ANËTARË KLASI NË NJË VEPRIM TË PRETENDUAR KLASI OSE PROCEDURË ME PËRFAQËSIM. Gjithashtu, përveç rasteve kur ju dhe "Lookout" bini dakord ndryshe, arbitri mund të mos bashkojë më shumë se një pretendim të një personi, dhe nuk mund të kryesojë në forma të proceseve të klasit ose me përfaqësim. Nëse ky paragraf specifik nuk zbatohet, atëherë nënseksionet 7(b)-(d) do të jenë të pavlefshme.

e. Çdo veprim që nuk i nënshtrohet arbitrazhit rregullohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e brendshme të shtetit të Nju Jorkut, SHBA, përfshirë statutet e kufizimeve, pa marrë parasysh statutet e huamarrjes, që do të sillnin zbatimin e statutit të kufizimeve në një juridiksion tjetër, dhe veprime të tilla duhet të trajtohen ekskluzivisht në gjykatat shtetërore ose federale të Nju Jorkut, dhe ju dhe "Lookout" jepni miratimin tuaj për vendin dhe gjykimin personal.

8. Çështje të përgjithshme

a. Veçueshmëria: Nëse një dispozitë e KeSH-it bëhet e pavlefshme ose e pazbatueshme, ajo do të modifikohet deri në masën e nevojshme për të ta paraqitur si të zbatueshme, pa humbur qëllimin e saj. Nëse një modifikim i tillë nuk është i mundur, dispozita do të veçohet nga KeSH-i dhe KeSH-i do të mbetet në fuqi dhe me efekt të plotë.

b. Mosheqja dorë: Moszbatimi ose vonesa në zbatimin e një dispozite sipas këtyre Kushteve nuk nënkupton heqje dorë nga të drejtat tona për zbatim në të ardhmen.

c. Moscaktimi ose mostranferimi: Ju nuk mund të transferoni ose të caktoni KeSH-in dhe asnjë të drejtë apo licensë që ju japim; ato mund të caktohen ose të transferohen nga "Lookout" pa kufizim.

d. Marrëveshja e plotë: Këto Kushte përbëjnë marrëveshjen e plotë mes jush dhe "Lookout" për Shërbimet e Ndërmarrjes përveç rasteve kur Ndërmarrja juaj ka një marrëveshje kuadër license me "Lookout", që përfshin kushtet e shërbimit të përdoruesit fundor. Nëse Ndërmarrja juaj ka një marrëveshje kuadër license, atëherë kushtet e asaj marrëveshjeje do të jenë përgjegjëse për çdo Kusht konfliktual. Në rastet kur këto Kushte zbatohen, ato zëvendësojnë të gjitha marrëveshjet e mëparshme ose aktuale mes jush dhe "Lookout".

e. Mund të modifikojmë KeSH-in: "Lookout" mund t'i modifikojë këto Kushte herë pas here në diskrecionin e tij të vetëm dhe absolut. Ju pranoni të zbatoni çdo ndryshim në KeSH nëse vazhdoni t'i përdorni Shërbimet e Ndërmarrjes, pasi ndryshimet të jenë publikuar. Për këtë arsye, lexojini me kujdes të gjitha ndryshimet. Versioni më aktual i KeSH-it gjendet te <https://legaldocs.lookout.com/en/enterprise-end-user-agreement.pdf>.

f. Nuk është synuar apo krijuar asnjë agjenci, partneritet, sipërmarrje e përbashkët, marrëdhënie punëdhënës-punëmarrës ose dhënës ekskluziviteti-përfitues ekskluziviteti përmes këtyre Kushteve.

g. Në rast përfundimi: Dispozitat që kërkojnë performancë pas përfundimit të këtyre Kushteve, dhe të gjitha

dispozitat që lidhen me kufizimin e përgjegjësisë, deklaratat për mospranim përgjegjësie dhe dëmshpërblimin sipas këtyre Kushteve do të zbatohen pavarësisht përfundimit të Kushteve.

DEKLAROJ SE I KAM LEXUAR DHE I KAM KUPTUAR KUSHTET E MËSIPËRME TË SHËRBIMIT DHE PRANOJ SE DUKE PËRDORUR NJË SHËRBIM, BIE DAKORD TA ZBATOJ MARRËVESHJEN SIPAS TERMAVE DHE KUSHTEVE TË KËSAJ MARRËVESHJEJE.